

Reforma e arsimit në Maqedoni

Program mësimorë:Fizika, klasa e 9 - të

viti 2016, Shkurt

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 nga Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 и 24/13), si dhe në bazë të nenit 6 dhe nenit 7, paragrafi 1, alineja 4 nga Ligji i Byrosë për zhvillim të arsimit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri për arsim dhe shkencë e vërtetoi Programin mësimorë nga *fizika* për klasën e VIII të arsimit fillorë nëntëvjeçarë.

Cambridge International Examination

Byroja për zhvillim të arsimit

PROGRAMI MËSIMORË

FIZIKA

FIZIKË

Për klasë të IX

Arsimi fillorë nëntëvjeçarë

Shkup, shkurt 2016

Hyrje

Programi mësimorë nga lënda e fizikës për klasë të nëntë të arsimit fillor nëntëvjeçarë është e marrë nga qendra ndërkombëtare për programet mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) dhe është e përshtatur nga ana e Byrosë për zhvillim të arsimit. Aprovimi dhe përshtatja e programit mësimorë është e fituar nga ekspertët e qendrës ndërkombëtare për programet mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations).

Ky program mësimorë i Kembrixhit përmban një tërësi të kuptueshme nga tërësitë graduale të të mësuarit nga lënda e fizikës në klasë të nëntë. Qëllimet e qartësojnë atë çka nxënësit duhet ta dinë ose duhet të jenë të aftë ta bëjnë në klasë të nëntë. Qëllimet e të mësuarit formojnë strukturën për ligjerim dhe mësim, por shërbejnë edhe si referim për verifikimin e aftësive dhe të kuptuarit e nxënësve.

Programi mësimorë përmaban hulumtim shkencorë. Me hulumtim shkencor nënkuptohet shqyrtimi i ideve, dëshmi të vlerësimit, planifikim të punës hulumtuese dhe vërejtja dhe analiza e të dhënave. Qëllimet e hulumtimit shkencorë janë ndihmëse për fizikën ku koncentrohen në zhvillimin e vetëbesimit dhe interesit për dituri shkencore. Programi mësimorë është themel i fortë mbi të cilat fazat e mëtejme arsimore mund të rindërtohen.

Programi mësimorë i Kembrixhit bazohet në vlerat e Universitetit „Kembrixh“ dhe praktika më e mirë në shkolla. Programi mësimorë i kushtohet zhvillimit nxënësve të cilët kanë vetëbesim, janë përgjegjës, inovativ dhe aktiv. Ajo është e projektuar që ti kuç nxënësit në një përvojë arsimore aktive dhe kreative. Ky program mësimorë është në mënyrë të veçantë është e përshtatur për nxënësit e Republikës së Maqedonisë.

Programi mësimorë duhet të realizohet me fond prej 2 orë në javë, gjegjësisht 72 orë në vjetë.

Pjesët e programit mësimorë për notim, kushtet e hapësirave për realizimin e mësimit dhe normativi për kuadrin mësimorë janë të dhëna në nenin 25 paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor.

Programi mësimorë për klasë të IX-të

1. Fushat dhe rezultatet e pritura

Hulumtim shkencorë

Idetë dhe dëshmitë

- Diskuton dhe shpjegon rëndësinë e pyetjeve, dëshmimeve dhe shpjegimeve duke përdorur shembuj historik dhe bashkëkohorë.
- I verifikon shpjegimet duke i përdorur ato në parashtrimin e parakushteve, e mandej i evaluon në raport të dëshmimeve.
- Diskuton në mënyrën në të cilën sot shkencëtarët punojnë dhe si kanë punuar në të kaluarën, duke i kyçur shembujt për eksperimente, dëshmitë dhe të menduarit kreativ.

Planifikon punim hulumtues

- Zgjedh ide dhe bën plane detale për kontrollim të bazuara në dijeninë, kuptimin dhe hulumtimin e mëparshëm .
- Propozon dhe përdor punë preliminare që të vendosë si ta kryejë hulumtimin.
- Vendos vallë a të përdorë fakte të rendit të parë ose burime sekondare.
- Vendos se cilat matje dhe vëzhgime janë të nevojshme dhe cilat pajisje duhet të përdoren.
- Vendos se cila pajisje duhet përdorur dhe i vlerëson rrisqet dhe rreziqet në laboratorin ose hapësirën punuese.

I gjen dhe i parashtron faktet

- Bën numër të caktuar vëzhgimesh dhe matjesh që të zvogëlohet gabimi dhe rezultatet të jenë më të besueshme.
- Përdor materiale dhe pajisje të ndyshme dhe merr masa për mbrojtje.
- Zgjedh mënyrën më të mirë që ti paraqesë rezultatet.

Shqyrton dëshmitë dhe qasjet

- I përshkruan prirjet dhe shabllonet(korrelacionet) që paraqiten tek rezultatet.
- Interpretton rezultatet me ndihmë të dijenisë dhe të kuptuarit shkencorë.
- Ka qëndrim kritik ndaj burimeve dytësore të të dhënave.
- Jep përfundime.
- I vlerëson metodat e përdorura dhe i përmirëson për hulumtimet e mëtutjeshme.
- I krahason rezultatet dhe metodat e përdorura nga të tjerat.
- Parashtron përfundimet dhe vlerësimet e metodave punuese në mënyra të ndryshme.
- I shpjegon rezultatet duke e përdorur dijeninë dhe të kuptuarit shkencorë. Në mënyrë të qartë i ndan me të tjerët.

Fizika

Forcat dhe lëvizja Сили и движење

- Shpjegon se si shtypja parqet veprim të forcës mbi sipërfaqen e caktuar, duke e kyçur edhe formulën për shtypjen = forca/sipërfaqen.
-
- Përcakton dendësinë e trupave të ngurtë, të lëngtë dhe të gaztë, duke e kyçur përdorimin e formulës për dendësi=masa/vëllimi.
-
- E diskuton ndodhinë që Arhimedi i ka krahasuar dendësitë që ta zbulojë përbërjen e një kurore.
-
- E shpjegon shtypjen tek gazrat dhe lëngjet(vetëm në mënyrë kualitative).
- E din që forcat mund ti shtyjnë trupat të rrotullohen dhe e kupton parimin e momentit, duke e kyçur përdorimin e formulës moment= distanca normale nga boshti i rrotullimit deri në kahjen e forcës x forca.

Eelektriciteti dhe magnetizmi

- E përshkruan elektroshtatiken dhe kapacitetin e ngarkesës dhe e din se ngarkesa mund të matet .
- Interpretin dhe vizatojnë qarqe të thjeshta paralele.
- Modelon dhe shpjegon se si komponentat(duke i kyçur qelitë/bateritë) e thjeshta ndikojnë në rrymën.
- Shpjegon se si rryma ndahet në qarqe paralele .
- Mat forcën e rrymës, tensionit dhe rezistencës duke përdorur instrumente matëse.
- Përshkruan vetitë e magnetëve.
- I njoh dhe i vizatojnë modelet e fushës magnetike të pllakës magnetike.
- Përpilon dhe përdor elektromagnetin.

Energjia

- Përdor njohuritë për burimet e energjisë, duke kyçur lëndët djegëse fosile dhe energjinë e ripërtirshme në raport të nevojave energjetike të botës.
- I identifikon dhe shpjegon proceset për transferin e energjisë së nxehtësisë nëpërmjet të konduktivitetit, konveksionit dhe rrezatimit.
- Shpjegon ftohjen nëpërmjet të avullimit.

Zëri

- I shpjegon vetitë e zërit nëpërmjet të lëvizjes së thërmijave ajrore.
- Shpjegon se valët e zërit përçojnë energjinë pa lëvizjen e thërmijave nga burimi deri tek detektori.
- Identifikon amplitudën dhe frekuencën e valëve të zërit me osciloskop.
- Përshkruan lidhjen ndërmjet zërit dhe amplitudës si dhe ndërmjet lartësisë dhe frekuencës.

2. Qëllimet konkrete, aktivitetet dhe mjetet për punë

GJYSMËVJETORI I 1	GJYSMËVJETORI I 2
1A Tema 9.1 Forca dhe lëvizja	2A Tema 9.3 Elektriciteti dhe magnetizmi
1B Tema 9.2 Eenergjia	2B Tema 9.4 Tingulli

Titujt e ligjëratave

GJYSMËVJETORI I 1					
Java	Ora	Titulli i ligjëratës	Java	Ora	Titulli i ligjëratës
Java e 1	Ora e 1	Hyrje në leva	Java e 9	Ora e 1	Çka është nxehtësia?
	Ora e 2	Studimi i levave		Ora e 2	Përçimi i nxehtësisë - konduccion
Java e 2	Ora e 1	Ekulibrimi i luhatëseve	Java e 10	Ora e 1	Përçimi i nxehtësisë - konveccion
	Ora e 2	Përdorimi i parimit të momenteve		Ora e 2	Përçimi i nxehtësisë - rrezatim
Java e 3	Ora e 1	Hyrje në dendësi	Java e 11	Ora e 1	Orë për përsëritje-nxehtësia dhe transferimi i nxehtësisë
	Ora e 2	Përcaktimi i dendësisë së materieve të ngurta katrore/ kuboide.		Ora e 2	Zvogëlimi i humbjes së nxehtësisë
Java e 4	Ora e 1	Përcaktimi i dendësisë së materieve të ngurta jokuboide.	Java e 12	Ora e 1	Ftohja – avullimi
	Ora e 2	Arhimeri dhe kurora e artë		Ora e 2	Orë përsëritje për transferim të nxehtësisë, izolimi dhe avullimi
Java e 5	Ora e 1	Dendësia e lëngjeve dhe gazrave	Java e 13	Ora e 1	Djegia e lëndëve djegëse
	Ora e 2	Përsëritje për momentin dhe dendësinë		Ora e 2	Energjia ripërtrirëse
Java e 6	Ora e 1	Nën shtypje	Java e 14	Ora e 1	Përdorimi botëror i energjisë
	Ora e 2	Përcaktimi i shtypjes(presionit)		Ora e 2	Energjia për një ishull (1)
Java e 7	Ora e 1	Presioni në gazra	Java e 15	Ora e 1	Energjia për një ishull (2)
	Ora e 2	Presioni në lëngje		Ora e 2	Energjia për një ishull (3)
Java e 8	Ora e 1	Përsëritje për shtypjen(presionin)	Java e 16	Ora e 1	Orë përsëritjeje për energji
	Ora e 2	Orë për përsëritje tematike		Ora e 2	Orë përsëritjeje për gjysmëvjetor

GJYSMËVJETORI I 2					
Java	Ora	Titulli i ligjëratisë	Java	Ora	Titulli i ligjëratisë
Java e 1	Ora e 1	Forcat e padukshme	Java e 11	Ora e 1	Demagnetizim
	Ora e 2	Çka janë ngarkesat?		Ora e 2	Orë përsëritjeje për magnetizmin
Java e 2	Ora e 1	Elektrostatika rreth nesh	Java e 12	Ora e 1	Orë për përsëritje tematike
	Ora e 2	Përpilimi i qarqeve elektrike		Ora e 2	Oscilimet dhe tingulli
Java e 3	Ora e 1	Matja e forces së rrymës tek qarqet elektrike serike	Java e 13	Ora e 1	Lëvizja e thërmijave ajrore
	Ora e 2	Matja e forces së rrymës tek qarqet elektrike serike me numër të ndryshëm të baterive		Ora e 2	Lartësia dhe frekuenca
Java e 4	Ora e 1	Matja e rrymës në qarqe elektrike paralele	Java e 14	Ora e 1	Zëri forca) dhe amplituda
	Ora e 2	Zgjedhja e detyrave për rrymën në qarqe elektrike		Ora e 2	Vizuelizimi i valëve tingullore në osciloskop
Java e 5	Ora e 1	Orë për përsëritje të ngarkesave dhe rrymës	Java e 15	Ora e 1	Zgjedhja e detyrave për valët e zërit të paraqitura në osciloskop
	Ora e 2	Të studiuarit e rezistencës (1)		Ora e 2	Orë për përsëritje të oscilimeve, lartësisë, frekuencës, amplitudës, zërit (forca) dhe valët e zërit.
Java e 6	Ora e 1	Të studiuarit e rezistencës (2)	Java e 16	Ora e 1	Valët e zërit përçojnë energji
	Ora e 2	Të studiuarit e rezistencës (3)		Ora e 2	Rreziqet nga tingujt me energji të lartë
Java e 7	Ora e 1	Hyrje në tension	Java e 17	Ora e 1	Dëbimi i valëve të zërit
	Ora e 2	Tensioni i qarqeve serike		Ora e 2	Orë përsëritjeje për përçimin e energjisë nëpërmjet të valëve të zërit dhe përdorimi i valëve të zërit
Java e 8	Ora e 1	Tensioni në qarqe paralele	Java e 18	Ora e 1	Matja e shpjetësisë së valëve të zërit (1)
	Ora e 2	Zgjedhja e detyrave lidhur me rrymën dhe tensionin e qarqeve elektrike		Ora e 2	Matja e shpjetësisë së valëve të zërit (2)
Java e 9	Ora e 1	Orë për përsëritje të elektricitetit	Java e 19	Ora e 1	Matja e shpjetësisë së valëve të zërit (3)
	Ora e 2	Vetitë e magnetëve		Ora e 2	Orë për përsëritje të temës
Java e 10	Ora e 1	Fushat magnetike	Java e 20	Ora e 1	Orë për përsëritje të materialit të gjysmëvjetorit

	Ora e 2	Elektromagnetët		Ora e 2	Orë për përsëritje të gjithë materialit
--	---------	-----------------	--	---------	---

Qëllimet e mësimit lidhur me hulumtim shkencor

Në shtesë janë qëllimet e mësimit lidhur me hulumtimin shkencorë për këtë klasë. Ato janë të shtuara në temat të parapara në këtë plan mësimesorë.

Idetë dhe dëshmitë

- Diskuton dhe shpjegon rëndësinë e pyetjeve, dëshmive dhe shpjegimeve duke përdorur shembuj historik dhe bashkëkohorë.
- I verifikon shpjegimet duke i përdorur ato në parashtrimin e parakushteve, e mandej i evaluon në raport të dëshmive.
- Diskuton në mënyrën në të cilën sot shkencëtarët punojnë dhe si kanë punuar në të kaluarën, duke kyçur shembuj për eksperimente, dëshmi dhe të menduarit kreativ.

Planifikon punim hulumtues

Zgjedh ide dhe bën plane detale për kontrollim të bazuara në dijeninë, kuptimin dhe hulumtimin e mëparshëm .

Propozon dhe përdor punë preliminare që të vendosë si ta kryejë hulumtimin.

Vendos vallë a të përdorë fakte të rendit të parë ose burime sekondare.

Vendos se cilat matje dhe vëzhgime janë të nevojshme dhe cilat pajisje duhet të përdoren.

Vendos se cila pajisje duhet përdorur dhe i vlerëson rrisqet dhe rreziqet në laboratorin ose hapësirën punuese.

I gjen dhe i parashtron faktet

Bën numër të caktuar vëzhgimesh dhe matjesh që të zvogëlohet gabimi dhe rezultatet të jenë më të besueshme.

Përdor materiale dhe pajisje të ndryshme dhe merr masa për mbrojtje.

Zgjedh mënyrën më të mirë që ti paraqesë rezultatet.

Shqyrton dëshmitë dhe qasjet

I përshkruan prirjet dhe shabllonet(korrelacionet) që paraqiten tek rezultatet.

Interpreton rezultatet me ndihmë të dijenisë dhe të kuptuarit shkencorë.

Ka qëndrim kritik ndaj burimeve dytësore të të dhënave.

Jep përfundime.

I vlerëson metodat e përdorura dhe i përmirëson për hulumtimet e mëtutjeshme.

I krahason rezultatet dhe metodat e përdorura nga të tjerat.

Parashtron përfundimet dhe vlerësimet e metodave punuese në mënyra të ndryshme.

I shpjegon rezultatet duke e përdorur dijeninë dhe të kuptuarit shkencorë. Në mënyrë të qartë i ndan me të tjerët.

GJYSMËVJETORI 1

Tema 1A: 9.1 Forcat dhe lëvizja

Nxënësit e rindërtojnë dijeninë e mëparshme për forcat dhe ndikimin e tyre që të mësojnë më shumë dhe ta kuptojnë shtypjen. Ato hulumtojnë se si thërrmijat bëjnë presion edhe në lëngje dhe në gazra dhe si llogaritet shtypja. Nënkuptohej edhe termi dendësi, ku do të bëhen llogaritjet dhe vlerësimi i koncentracionit të thërrmijave. Nxënësit do ta përcaktojnë dendësinë e materieve të ngurta, lëngjeve dhe gazrave, dhe do ta hulumtojnë punën e Arhimedit në këtë fushë. Nxënësit rikujtohen për ndikimin e forcave dhe rindërtohet kjo dijeni, si dhe ajo që forcat mund të jenë shkaktarë që lëndët të rrotullohen rreth boshtit të vetë si dhe ta kuptojnë parimin e momentit, duke e përfshirë edhe përdorimin e formulës $\text{momenti} = \text{distanca normale nga boshti deri në kahjen e forcës} \times \text{forca}$.


Hulumtimi shkencorë bazohet në :

- Vendosja se cilat matje dhe vëzhgime janë të nevojshme dhe cila pajisje të përdoret dhe vlerësimi i çfarëdo risku dhe rreziqeve në laborator ose në hapësirën punuese.
- Kryerja e matjeve dhe vëzhgimeve të shumta që të zvogëlohet gabimi dhe rezultatet të jenë më të besueshme.
- Interpretimi i rezultateve duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.
- Dhënia e përfundimeve.
- krahasimi me të tjerat.

Terme të propozuara për këtë temë

<p>Boshti i rrotullimit ngarkesë forca e përdorur levë makinë baraspeshë moment forca e rrotullimit ekuilibri momenti në kahje të akrepave të orës momenti në kahje të kundërt me akrepat e orës dendësia vëllimi masa shtyn zhyt gas lëng thërrmija Presion(shtypje) forcë fushë peshë studim shtypje frekuencë model i gazit Arkimedi</p>	<p>Hulumtim shkencorë vëzhgon mat llogarit shpjegon trend model përfundon përdor dizajnon planifikon studjon krahason bën dallime hulumton përmbledh rezultati në përjashtim</p>
--	---

Qëllimet e mësimit	Aktivitetet e propozuara	Mjetet mësimore	Terminologjia
Java e 1			
<u>Java e 1</u> E din që forcat mund ti detyrojnë trupat të rrotullohen dhe e kupton parimin e momentit, duke e përfshirë përdorimin e formulës momenti - distanca normale nga boshti i rrotullimit deri në kahjen e forcës x forca.	<u>Ora e 1</u> <u>Hyrje në leva</u> <ul style="list-style-type: none"> Tregoni nxënësve disa detyra që vështirë mund të bëhen me dorë të thjeshtë. Për shembull: hapje të një kapaku të mbyllur fortë, rrotullimin e dorezës, thyerje të arrës ose nxjerrja e gozhdës nga një pjesë të drurit. Bisedoni me nxënësit pse këto detyra vështirë bëhen me dorë të lire. <i>Me cilat mjete më lehtë mund të kryhen këto aktivitete?</i> <p>Tregojuni mjete të thjeshta ose makina që mund të ndihmojnë (Psh. kaçavidë ose levë, çels për rrotullim, thyese të arrave ose darë, çekiç). <i>Pse me këto na lehtësohet puna?</i> Diskutoni për përgjigjet e nxënësve.</p> <ul style="list-style-type: none"> Tregoni se si hapet kova me kapak të mbyllur. Përshkruani përdorimin e levës si makinë të thjeshtë e cila e përdor boshtin e rrotullimit. Kahëzojeni boshtin , ngarkesën dhe forcën e përdorur. Tregoni për mjete ose pajisje të tjera. Për çdo shembull të dhënë, nxënësit le të tregojnë cila është boshti i rrotullimit, ngarkesa dhe forca e përdorur.. Tregoni video klip për përdorimin e levave. Nxënësit të tregojnë vallë a i shohin dhe ku i shohin levat në këtë video klip. Përfundoni që leva është mjet i thjeshtë. Për çdo levë mund të paraqitni boshitn e rrotullimit, ngarkesën dhe forca e përdorur. 	Shembuj për leva të thjeshta, për shemb. mjet për thyerjen e arrave, çelës për hapje të dorezës, konserva me kapak të mbyllur. Konzerva (për sh. Kovë me ngjyrë) me kapak të mbyllur, kaçavidë. Linku i propozuar: https://youtu.be/QejD6z69trg	Boshti i rrotullimit ngarkesë(barrë) forca e përdorur levë makinë vëzhgon shpjegon
<u>Java 1</u> E din që forcat mund ti detyrojnë trupat të	<u>Ora e 2</u> <u>Të studiuarit e levave</u> <ul style="list-style-type: none"> Tregojuni nxënësve foto të çelësit për rrotullim e 		Boshti i rrotullimit Ngarkesë(barrë) forca e përdorur levë

<p>rrotullohen dhe e kupton parimin e momentit, duke e përfshirë përdorimin e formulës $\text{momenti} = \text{distanca normale nga boshti i rrotullimit deri në drejtimin e forcës} \times \text{forca}$.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p>Bën vëzhgime dhe matje.</p> <p>I përshkruan trendet dhe shabllonet (korelacionet) që paraqiten në rezultatet.</p> <p>Jep përfundime.</p>	<p>cila përdoret për lirim të vidës. <i>Ku është boshti i rrotullimit këtu?</i> Nxënësit le të propozojnë dy gjëra të cilat, përderisa i ndryshojnë, do të ndryshohet edhe forca e rrotullimit të vidës. Nxirrni dy ndryshore kyçe (1) fuqia e forcës së ndryshuar tek çelësi për rrotullim, dhe (2) distanca përgjatë dorëzës së çelësit mbi të cilën përdoret forca.</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit mund të hulumtojnë forcat në një levë të thjeshtë. Ato le ta ndryshojnë distancën ndërmjet boshtit të rrotullimit dhe forcës së shfrytëzuar dhe le ta masin madhësinë e forcës e cila është e nevojshme që të ngrihet barra. Përderisa leva është linjar, atëherë është lehtë të matet largësia nga leva deri në pikën ku është përdorur forca. Madhësia e veprimit të këtillë mund të matet me dinamometër. Madhësia e barrës duhet të ngjehet e njëjtë. Nxënësit le të përpilojnë tabelë me rezultatet e tyre e cila do tju ndihmojë të vizatojnë grafikun linjar. Ato duhet ta përshkruajnë trendin dhe të japin përfundime. Parashtrëni pyetjen se si të llogaritet momenti me përdorimin e formulës: Momenti - distanca normale nga boshti i rrotullimit deri në drejtimin e forcës \times forca. <p>Nxënësit i llogarisin momentet nga hulumtimi. Në mënyrë ideale, të gjitha rezultatet e tyre duhet ta japin momentin e njëjtë. <i>Vallë a është kjo përgjigjja jote? Vallë a kishit disa probleme gjatë hulumtimit? Si do ta kishit përmirësuar nëse e përsërisni edhe njëherë tjetër?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Përfundoni se momenti i forcës = distanca normale nga boshti i rrotullimit deri në drejtimin e forcës \times forca, dmth ose me zmadhimin e forcës, zmadhohet 	<p>Linjar, dinamometra dhe ngarkesa (barra) të vogla</p>  <p>Kalkulator (sipas dëshirës).</p>	<p>makinë momenti forca e rrotullimit</p> <p>trend shabllon përfundon</p>
--	--	--	---

momenti.			
Java 2			
<p>Java2 E din që forcat mund ti detyrojnë trupat të rrotullohen dhe e kupton parimin e momentit, duke e përfshirë përdorimin e formulës momenti = distanca normale nga boshti i rrotullimit deri në kahjen e forcës x forca.</p> <p>Bën vëzhgime dhe matje.</p> <p>I përshkruan trendet dhe shabllonet(korelacionet) që paraqiten në rezultatet</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p>	<p>Ora e 1 <u>Ekulibrimi i luhatëseve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Tregojuni nxënësve luhatëse në baraspeshë. Pyetni se ku është boshti i rrotullimit. Shtoni masë të caktuar në njërën anë të luhatëses dhe kërkonin nga nxënësit ta llogarisin momentin. Jepni nxënësve luhatëse në baraspeshë. Kërkonin nga ato ti vendosin dy masat në shumë mënyra të mundshme të vendosura në 6cm nga boshti, por të mbetet në baraspeshë. Nxënësit le ti vendosin rezultatet në tabelë. Kërkonin nga nxënësit ta llogarisin momentin prej 2 masave të vendosura në largësi 6 cm nga boshti. Kontrolloni përgjigjet e tyre. Mandej kërkonin nga nxënësit ti llogarisin momentet nga të gjitha kombinimet që kanë arrirë të fitojnë ekulibër të luhatëses. Nxënësit duhet të jenë të aftë ta njohin shabllonin dhe ta përcaktojnë parimin se luhatësja është në baraspeshë kur: Momenti në kahje të akrepave të orës - momentin në kahje të kundërt me akrepat e orës Mundësia tjetër është që nxënësit të përdorin simulim që të hulumtohet ekulibri tek luhatëset. Si aktivitet argëtues, tregojuni një luhatëse. Vendosni masë të madhe në njërën anë të luhatëses (për shembull , arsimtari, por mos e mirrni si shembull nxënësin si masë të madhe). Nxënësit le të ofrojnë si masë më të vogël (shemb. Vullnetar ose nxënës më të 	<p>Luhatësja në ekulibër, boshte rrotullimi të caktuara, pesha me masa të barabarta (shemb. 10 g = 0.1 N), metra për matje.</p> <p>Luhatësja në ekulibër, boshte rrotullimi të caktuara, pesha me masa të barabarta (sh. 10 g = 0.1 N), metra për matje.</p> <p>.</p> <p>https://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/balancing-act (simulacioni është i mundshëm në shqip, maqedonisht, sërbsisht ose gjuhë turke) ose http://www.freezeray.com/flashFiles/balancedBeam.htm</p> <p>Pesha më të mëdha, dërrasë druri, boshti i madh. Vërejtje: që të tejkalohen situatat e papëlqyeshme , mos mirrni nxënës si shembuj</p>	<p>Boshti i rrotullimit ngarkesë(barrë) forca e përdorur levë makinë momenti forca e rrotullimit baraspesha momenti në drejtim të akrepave të orës momenti i kundërt me drejtimin e akrepave të orës</p> <p>trend shabllon përfundim</p>

	<p>vogël) mund të arrihet të vendoset baraspesha.</p> <p>Nxënësit le të provojnë mënyra të ndryshme si luhatësja të arrijë baraspeshë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësve jipni shembuj që të mund të llogariten momentet. Shembull interesant mund të jetë nëse paramendohet luhatëse ku në njërin anë është elefanti , ndërsa ne mundohemi ta arrijmë baraspeshën me vendosjen e miut në anën tjetër. Përfundoni se momentet mund të maten, llogariten dhe parashikohen. Luhatësja do të jetë në ekuilibër përderisa momentet janë të barazuara momentet në kahje të akrepave të ores dhe në kahje të kundërt të akrepave të ores. 	<p>për masë të madhe..</p> <p>Vërejtje: në këtë rast nuk është e nevojshme që të llogariten momentet sepse kjo mund ti turpërojë vullnetarët.</p> <p>Kalkulatorë.</p>	
<p><u>Java 2</u> E din që forcat mund ti detyrojnë trupat të rrotullohen dhe e kupton parimin e momentit, duke e përfshirë përdorimin e formulës momenti = distanca normale nga boshti i rrotullimit deri në kahjen e forcës x forca.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p>I shpjegon rezultatet duke shfrytëzuar dijeninë dhe kuptimin shkencorë. Në mënyrë të qartë i ndan me të tjerët.</p>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Përdorimi i parimit të momenteve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Tregoni nxënësve video klip të një trupi të madh (për shembull kamion për transport të automjeteve që është rrokullisur). Duke formuar çifte, nxënësit e përdorin termin moment që ta shpjegojnë ndërmjetveti se çka ka ndodhur. Jipni listë të termeve kyçe që nxënësit duhet ta përdorin në shpjegimet e tyre. Planifikoni një sfidë për nxënësit, të cilët do të mund ta zgjedhin me përdorimin e momenteve. Për shembull kërkoni nga ato të dizajnojnë mjet e cila mund t'u ndihmojë më të moshuarve më lehtë ti hapin kapakët fortë të mbyllura të kavanozi t me ushqim. Në dizajnin e tyre duhet qartë të : <ul style="list-style-type: none"> Ti paraqesin pjesët e levës Të shpjegojnë se si momenti rritet pa pasur nevojë që personi të përdorë forcë më të madhe Kërkoni nga një nxënës ta hapë derën. Kërkoni nga nxënësi tjetër ta ndalojë qëllimin që e ka me çka do të përdorë forcë në largësi të ndryshme nga mentesheja. 	<p>Linku i propozuar: https://youtu.be/zhxhbakxxbl</p>	<p>Boshti i rrotullimit ngarkesë(barrë) forca e përdorur levë makinë momenti forca e rrotullimit baraspesha momenti në drejtim të akrepave të orës momenti i kundërt me drejtimin e akrepave të orës</p> <p>përdor dizajnon planifikon</p>

	<p>Kërkoni nga nxënësit ti shpjegojnë rezultatet duke e përdorur konceptin e momentit. Jepni listën e termeve kyçe ku nxënësit do ti përdorin gjatë shpjegimeve të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfundoni se koncepti për momentet mund të përdoret në disa situata. 		
Java 3			
<p><u>Java 3</u></p> <p>Përcakton dendësinë e trupave të ngurtë, lëngjeve dhe gazrave ,duke e përfshirë përdorimin e formulës dendësia=masa / vëllimin</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë</p> <p>Jep përfundime.</p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Hyrje në dendësi</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregoni video klip të një lënde prej gome e cila hidhet në drejtim të njerëzve, ku ato mendojnë se është më i rëndë sesa që është në të vërtetë. Diskutoni për kripin. <i>Pse njerëzit ikin nga kjo lëndë? Vallë lëndët e mëdha janë çdo herë më të rënda?</i> • Nxënësit i mësojnë masat e materjaleve të ndryshme me madhësi të barabartë. Ato le të mundohen ta përcaktojnë masën të çdo materiali dhe le ti paraqesin rezultatet në tabelë. (siguroni tabelë në hapësirë në të cilën mund të llogaritet dendësia). <p>Tregoni se si përcaktohet dendësia e një trupi. Nxënësit e plotësojnë tabelën me vlerat për dendësi të të gjitha shembujve të marra.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nxënësit japin sugjerime në pyetjen se pse lëndët kanë dendësi të ndryshme. Që tu ndihmoni, tregoni tre kuti papka (me masa të ndryshme) të njëjta. Pyetni <i>Pse kutitë kanë masa të ndryshme?</i> Nxirrni idenë se kutitë përmbajnë numër të ndryshëm të lëndëve, të cilat kanë masa të ndryshme. Lidhni këtë ide se atomet kanë masa, madhësi të ndryshme dhe mund të grupohen në mënyra të ndryshme. • Përfundoni se materialet e ndryshme mund të kenë 	<p>Linku i propozuar: https://youtu.be/fE67XeUeaHY</p> <p>bloqet nga materiale të ndryshme me madhësi të barabartë (për shemb. 1cm³): nga çeliku, druri, alumini, zinku, stiropori, plumbi, tulla, mermeri, guri, porcelain etj.</p> <p>Vërejtje: këto ide ndërlidhen me termet me të cilat nxënësit i kanë hasur në lëndën e Kimisë. Në këtë klasë ato duhet të kenë njohuri detale për dendësinë të shkaktuar nga vetitë e atomeve.</p>	<p>dendësia vëllimi masa</p> <p>studion krahason bën dallime</p>

	masa të ndryshme edhe pse vëllimi i tyre është i njëjtë. Dendësia llogaritet me formulën masa / vëllimi.		
<p>Java 3 Përcakton dendësinë e trupave të ngurtë, lëngjeve dhe gazrave ,duke e përfshirë përdorimin e formulës dendësia=masa / vëllimin</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë</p> <p>Vendos se cilat matje dhe vëzhgime janë të nevojshme dhe cila pajisje duhet të shfrytëzohet.</p> <p>Jep përfundim.</p> <p>Kryen vëzhgime dhe matje.</p>	<p>Ora e 2 <u>Përcaktimi i dendësisë së trupave të ngurtë katrore(kuboide)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Tregoni nxënësve një torbë me stiropor dhe bllok çeliku. (Të dy lëndët le të kenë masë prej 1kg – por këtë mos ua tregoni). <i>Cila është më e rëndë? Cila është më e dendur?</i> Diskutoni për problemin e përcaktimit të dendësisë ose masës pa instrumente matëse të caktuara për këtë detyrë. Jepni shembuj nxënësve që ti hulumtojnë. Ato duhet të jenë pllaka katrore me madhësi të ndryshme dhe materiale të ndryshme.. Nxënësit le të përsërisin si përcaktohet vëllimi i formave (shemb. gjatësia x gjerësia x lartësia) katrore(kuboide). Nxënësit le ta masin masën e çdo lënde, duke i vërejtur rezultatet dhe le ta përcaktojnë dendësinë. Siguroni lëndët të cilat nuk janë të shënuara. Nxënësit le ta llogarisin dendësinë e tyre. Mandej me ndihmën e të dhënave për dendësi, le ta vërtetojnë prej cilit material janë të punuara. Përfundoni se, që të përcaktohet dendësia, masa dhe vëllimi duhet saktësisht të maten. 	<p>Torbë me stiropor (me peshë prej 1kg) dhe çelik (me peshë 1kg), dynamometer (në kg).</p> <p>Kalkulatorë ,linearë, peshore (me përjashtim prej ± 0.5 g) Pllaka drejtkëndëshe prej materiale të ndryshme me madhësi të ndryshme.</p> <p>Mostra e materialeve (të pashënuara).</p>	<p>dendësia vëllimi masa</p> <p>bën matje llogarit</p>
Java 4			
<p>Java 4 Përcakton dendësinë e trupave të ngurtë, lëngjeve dhe gazrave ,duke e përfshirë përdorimin e formulës dendësia=masa /</p>	<p>Ora e 1 <u>Përcaktimi i dendësisë së materjalve të ngurta jokuboide</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Tregojuni nxënësve lëndë të ndryshme me forma të ndryshme(shemb. Cilindrike, sferike, drejtkëndëshe, пр. цилиндрични, сферте parregullt) . <i>Cilat informata janë të nevojshme që të përcaktohet dendësia? Si mund të përcaktohet vëllimi i këtyre lëndëve?</i> 	<p>Lëndë të ndryshme të cilat kanë formë të rregullt ose të parregullt.</p>	<p>dendësia vëllimi masa shtyn zhyt</p> <p>mat</p>

<p>vëllimin</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë</p> <p>Vendos se cilat matje dhe vëzhgime janë të nevojshme dhe cila pajisje duhet të shfrytëzohet.</p> <p>Jep përfundim .</p> <p>Kryen vëzhgime dhe matje.</p>	<p>Nxënësit ndoshta e dine formulën për përcaktimin e vëllimit të trupave të ndryshëm të ngurtë nga lënda e Matematikës.Përkujtoni se të gjitha këto formulat mund të përdoren në Fizikë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregoni se si mund të zhyten trupat e ngurtë të parregullt në lëngje. Me matjen e vëllimit të ujit e cila është e zhvendosur, mund të përcaktohet vëllimi i trupit të çfarëdoshëm (duke i përfshirë edhe ato me formë të parregullt). • Nxënësit le ta përcaktojnë vëllimin e materjaleve me formë të parregullt nëpërmjet të vëllimit të lëngut të zhvendosur.Mandej le ta llogarisin dendësinë e çdo lënde. <p>Nxënësit i vërejnë dhe i interpretojnë rezultatet e tyre. Ato i krahasojnë rezultatet e tyre me ato të nxënësve tjerë të klasës. Pyetni vallë a ekziston ndonji nxënës që ka rezultate të ndryshme(të cilat nuk përputhen në shabllonin).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfundoni dse vëllimi i lëndëve të ngurtë me formë të parregullt mund të përcaktohet nëpërmjet të lëngut të zhvendosur. Ky vëllim mund të përdoret për përcaktimin e dendësisë së trupit. 	<p>Vërejtje: nxënësit ndonjëherë nuk janë të pregaditur atë çka e kanë mësuar në një lëndë ta përdorin në lëndë tjetër. Prandaj mjaftë me rëndësi është qartë tu tregohet ku është lidhshmëria ndërmjet lëndëve të ndryshme kur kjo dukuri paraqitet.</p> <p>Lëndët me formë të parregullt ,uji, cilindri për matje, enë për mbledhjen e lëngut të derdhur ose enë laboratorike(ose ngjajshëm).</p> <p>Lëndët me formë të parregullt ,uji, cilindri për matje, enë për mbledhjen e lëngut të derdhur ose enë laboratorike(ose ngjashëm). Peshore(me devijim prej ± 0.5 g)</p>	<p>Ilogarit rezultat me përjashtime</p>
<p><u>Java 4</u></p> <p>Përcakton dendësinë e trupave të ngurtë, lëngjeve dhe gazrave ,duke e përfshirë përdorimin e formulës dendësia=masa / vëllimin</p> <p>E diskuton ngjarjen në të</p>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Arkimedi dhe kurora e artë</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregojuni klasës disa lëndë me formë të parregullt prej materialeve të (mos iu tregoni emrat e materjaleve). Nxënësit le ta qëllojnë si mund të përcaktohen materialet. <i>Si mund ta përdorim dendësinë që të përcaktohet materiali? Si mund ta përdorim dendësinë që të përcaktohet pastërtia e materialeve?</i> 		<p>E pastër E papastër plastike dendësia vëllimi masa zhvendos zhyt Arhimedi</p>

<p>cilën Arkimedi i ka krahasuar dendësitë që ta zbulojë përbërjen e një kurore.</p> <p>Diskuton për mënyrën se si shkencëtarët sot punojnë dhe si ato kanë punuar në të kaluarën duke i përfshirë shembujt për eksperimentim , dëshmitë dhe të menduarit kreativ.</p> <p>Ka qëndrim kritik ndaj burimeve sekondare të të dhënave.</p> <p>Nxjerr përfundime.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjego hyrjen e ngjarjes së Arhimedit dhe kurorës së artë. Pyetni nxënësit se si Arkimedi e ka shfrytëzuar dendësinë si veti që ta zbulojë vallë kurora është e bërë vetëm nga ari. • Nxënësve jipni burime të informatave (të shtypura ose material nga Interneti) . Nxënësit e mësojnë ngjarjen e Arhimedit dhe kurorës së artë dhe i përgjigjen pyetjeve : <ul style="list-style-type: none"> • <i>Cili ka qenë problemi që Arkimedi është dashtë ta zgjedhë?</i> • <i>Pse ka bërë titull Eureka?</i> • <i>Cilën metodë të thjeshtë ka mundur ta përdorë? Nxënësit që dëshirojnë sfidë më të madhe mund ta hulumtojnë dhe ta vlerësojnë këtë histori.</i> • <i>Vallë kjo metodë e thjeshtë a do të jetë mjaftë e saktë? Cilën metodë tjetër ka mundur ta përdorë Arkimedi?</i> • Jepni nxënësve lëndë, prej të cilave disa janë të pastërta, e disa nuk janë. Mund të bëni lëndë edhe nga argjiri ose plastelina, me çka brenda dot fshihni lëndë të vogla. Nxënësit, me kryerjen e eksperimenteve, nëpërmjet të dendësisë mund të zbulojnë se cilat lëndë janë të pastërta. • Përfundoni që dendësia mund të përdoret për përcaktimin e përbërjes së materialeve. Ndërkaq edhe legjenda thotë kështu, se me këtë mënyrë Arkimedi e ka testuar kurorën që të shih vallë është përpunuar nga ari i pastër. 	<p>Burimet informative për nxënësit.</p> <p>Shembuj të ndryshëm (të pastërta dhe përzierje). Për shembull argjil/polastelinë për modelim, dhe materialin e njëjtë por me materiale të ndryshme të fshehur në to, kushineta të vogla, topta stiropori, copëza druri.</p> <p>Lëndët me formë të parregullt ,uji, cilindri për matje, enë për mbledhjen e lëngut të derdhur ose enë laboratorike(ose ngjashëm).</p> <p>Peshore(me devijim prej ± 0.5 g)</p>	<p>hulumton përmblendh</p>
Java 5			
<p><u>Java 5</u></p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Dendësia e lëngjeve dhe gazrave</u></p>		<p>dendësia gas</p>

<p>Përcakton dendësinë e trupave të ngurtë, lëngjeve dhe gazrave ,duke e përfshirë përdorimin e formulës $dendësia = \frac{masa}{vëllimin}$</p> <p>Kryen hulumtime dhe matje.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p><u>Nxjerr përfundime</u></p>	<ul style="list-style-type: none"> Pyetni nxënësit vallë a mund të përcaktohet dendësia e lëngjeve dhe gazrave. <i>Si mundemi ta masim vëllimin e lëngut? Si mund ta masim masën e lëngjeve? Si mundemi ta masim vëllimin e gazrave? Vallë gazrat kanë masë? Si mundemi ta masim masën e gazit?</i> Nxënësit le ta masin dendësinë e lëngjeve të ndryshme (shemb. Tretje kripës ose sheqerit). Demonstroni para nxënësve mënyrën më të thjeshtë të matjes së masës dhe vëllimit të gazrave. Vendosni shirit ngjitës në tasin dhe barazojeni peshën deiri në zero. Vendosni ballon të shprazët në peshore për matje. Fryjeni ballonin. Keni kujdes balloni mos bie nga peshorja ,me ndihmën e shiritit. Matni masën e ballonit dhe ajrit. Llogaritni masën e gazit. <p>Llogaritni vëllimin ballonit nën supozim nëse është top/sferë ($vëllimi = \frac{4}{3} \pi r^3$).</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit le ta mbledhin gazin e cila lirohet gjatë reaksionit kur tableta kundër aciditetit hidhet në ujë. Kryeni këtë reaksion në kungulleshë dhe mblidheni gazin e përfituar në ballonin. Në mënyrë eksperimentale përcaktoni dendësinë e gazit. <p>Plotësoni listën me të dhënat ku është e shprehur dendësia e gazrave të ndryshëm. Nxënësit mundohen ta përcaktojnë gazin nga dendësia e saj. <i>Pse gazrat e ndryshëm kanë masa të ndryshme?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Aktivitet plotësues : nxënësit mund ta shfrytëzojnë dijeninë nga lënda e Kimisë që të parashtrojnë mënyra të ndryshme se si të përcaktohet se cila materie e gastë 	<p>Shumica e nxënësve e kanë problem që ta kuptojnë se gazrat kanë masë. Me rëndësi është që të njihen dhe të qartësohen termet gabimisht të kuptuara.</p> <p>Shembuj të ndryshëm për lëngje. Cilindër për matje, Peshore (me devijim prej ± 0.5 g)</p> <p>Peshore (me devijim prej ± 0.01 g) Ballon, shirit ngjitës</p> <p>Metodë tjetër për përcaktimin e dendësisë së materies së gastë duke përdorur shiringa është: E propozuar në linkun: https://youtu.be/6V6f8P_WIQ4</p> <p>Peshore (me devijim prej ± 0.01 g) Ballon, shirit ngjitës, tablet kundër aciditetit, kungulleshë.</p> <p>http://wiki.gekgasifier.com/w/page/6123697/Densities%20of%20Common%20Gasses</p>	<p>lëng</p> <p>mat</p> <p>llogarit</p> <p>krahason</p> <p>bën dallime</p>
---	--	--	---

	<p>fitohet. Ato mund ta shënojnë barazimin për reaksionin me përdorimin e fjalëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfundoni se gazrat kanë masë. Dendësia mund të llogaritet edhe tek materiet e ngurta , të lëngta si dhe tek të gazta. 		
<u>Java 5</u>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Orë për përsëritje</u></p> <p>Orë për përsëritje për momentin dhe dendësinë.</p>		
Java 6			
<p><u>Java 6</u></p> <p>Shpjegon se si shtypja paraqet veprim të forcës mbi sipërfaqen e caktuar, duke e përfshirë përdorimin e formulës shtypja= forca/sipërfaqen.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë</p> <p>Shpjegon rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p>Jep përfundime .</p> <p>Kryen vëzhgime dhe matje</p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Nën presion(shtypje)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregojuni nxënësve këtë informacion : ‘Fëmijët luajnë me katrorë të vegjël plastik dhe i vendosin në dysheme. Kur shkelin nëpër to këmbëzbathur, nuk dhemb aspak. Por, kur një njeri i moshuar do të shkelë këmbëzbathur, me të vërtetë dhemb shumë!’ <p>Nxënësit le të diskutojnë për këtë në çifte. <i>Vallë a pajtoheni me këtë informacion? Pse ka dallim në dhimbje?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tregojuni video klip të burrave që janë të shtrirë në krevat me gozhdë. <i>Si nuk lëndohen ?</i> • Nxënësve jepni masa/pesha dhe argjil/plastelinë për modelim. Së pari, peshën vendoseni direkt mbi copën e plastelinës. Mandej bëjeni të njëjtën mbi katrorin e vogël prej 1 cm³ nga plastelina. Mandej, nxënësit le ta krahasojnë shenjën e vulosur mbi plastelinën në të dyja shembujt. Shenjat më të thella të vulosura në shembullin e dytë tregojnë se shtypja ka qenë më e madhe në rastin e dytë. 	<p>Linku i propozuar: https://youtu.be/QfdBwkOxCe4</p> <p>Sipas grupit: masa/ pesha (për shemb. prej 100-500 g), argjil/plastelinë për modelim, katror prej 1cm³</p>	<p>Presion(shtypje) forcë sipërfaqe peshë</p> <p>studion vëzhgon</p>

	<p>Mandej, nxënësit le ti krahasojnë shenjat e vulosura mbi plastelinën kur masa është aplikuar mbi 12 katorë. Më pas të njëjtën masë le ta vendosin mbi katrorët 8, 6, 4, 2 dhe 1 dhe krahasoni rezultatet. <i>Në cilën mënyrë sipërfaqja ndikon mbi shtypjen?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit le ta përsërisin këtë studim, por kësaj radhe sipërfaqja le të ngelë e njëjtë, ndërsa masa le të zmadhohet. <i>Në cilën mënyrë forca ndikon në shtypjen?</i> Nxënësit i përdorin termet e mësuara për forcën që të shpjegojnë <ul style="list-style-type: none"> <i>Pse krevati prej gozhdëve nuk dhemb aq shumë?</i> <i>3Pse të moshuarit ndjejnë dhimbje më shumë sesa fëmijët kur do të ndalen mbi katrorët të vegjël plastik?</i> Përfundoni pse forca e zmadhuar e zmadhon shtypjen, ndërsa sipërfaqja më e madhe e zvogëlon shtypjen. 	<p>Sipas grupit: masa të ndryshme (shemb. 100-500 g), plastelinë për modelim, katrorë prej 1cm³</p>	
<p><u>Java 6</u></p> <p>Shpjegon se si shtypja paraqet veprim të forcës mbi sipërfaqen e caktuar, duke e përfshirë përdorimin e formulës shtypja= forca/sipërfaqen.</p> <p>Shpjegon rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë. Quartë i ndan me të tjerët.</p>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Llogaritja e shtypjes(presionit)</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Tregoni një thikë shumë të sprefur ose lëshoni një video klip të shkurtër me thikë të sprefura. Kërkoni nga nxënësit ta përdorin atë çka e kanë mësuar nga ora e mëparshme që të shpjegojnë se çka e bën thikën aq efikas. Pyetni nxënësit <i>Si funksionon kunja me të cilën i varim vizatimet në mur ?</i> Jipni idenë se në një pjesë ka sipërfaqe më të madhe (forca është e shpërndarë përgjatë sipërfaqes më të madhe të gishtit) . Nga ana tjetër ka pikë/gjemb, ashtu që, forca e njëjtë është e përqendruar mbi sipërfaqen më të vogël. 	<p>Linku i sygjeruar: https://youtu.be/Kry8tD-bz7I</p> <p>Kunjë për varjen e vizatimeve në mur</p>	<p>Presion(shtypje) sipërfaqe forca</p> <p>llogarit</p>

	<ul style="list-style-type: none"> Kujtoni nxënësit të vendosin peshë/masë mbi katrorët. Ndhmoni nxënësit në mënyrë formale ta diskutojnë termin për shtypjen. 24 N mbi katrorin me $4 \times 1 \text{ cm}^2 = 6 \text{ N}$ mbi çdo katror . 24 N mbi katrorin me $8 \times 1 \text{ cm}^2 = 3 \text{ N}$ mbi çdo katror <p>Paraqitni barazimin për shtypjen = forca/sipërfaqen (e matur në N/cm^2)</p> <ul style="list-style-type: none"> Jepni nxënësve të dhëna që të ushtroni llogaritjen e shtypjes, forcës ose sipërfaqes. Shembuj që mund ta përdorni janë presioni që kryen gruaja e cila mban këpucë skijimi, patika ose këpucë me taka të holla. Nxënësve jepni informacione (të shtypur ose në Internet). Ato le të hulumtojnë mënyrat në të cilën forca mund të zgjerohet ose të përqëndrohet, ku ndryshon shtypja. Për shembull, gomat e gjera tek automjetet terrenike, sikurse të tankut, bazat betonike të ndërtesave, forma e bulonave rrotulluese etj. Përfundoni se shtypja = forca/sipërfaqja (e matur në N/cm^2). Shtypja mund të ndryshojë nëpërmjet të forcës së ndryshuar e cila ndikon mbi sipërfaqen. 	Të dhënat për nxënësit.	
--	---	-------------------------	--

Java 7

<p><u>Java 7</u></p> <p>Shpjegon se si shtypja paraqet veprim të forcës mbi sipërfaqen e caktuar, duke e përfshirë përdorimin e formulës shtypja = forca/sipërfaqen.</p> <p>E shpjegon shtypjen në gazra dhe lëngje (vetem</p>	<p><u>Ora e 1</u></p> <p><u>Shtypja tek gazrat</u></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësve tregoni dy ballonë që janë të fryra deri në madhësi të njëjtë. (Ato duhet të jenë rreth 80% të mbushura me ajër.) Vendoseni njërin ballon në friz, ndërsa tjetrin vendoseni në dhomë. Nxënësit në çifte le të supozojnë çka do të ndodhë dhe le të shërbehen me ide shkencore duke dhënë shpjegime. 	<p>Dy ballonë të fryrë me madhësi të njëjtë, friz ose vend tjetër të ftohtë.</p> <p>Ballonë, flaka e Bunzenit, syze mbrojtëse dhe kungulleshë.</p>	<p>gas përplasje shtypje forca shpeshtësi/frekuencë model i gazit</p> <p>vëzhgim krahason bën dallime</p>
--	---	--	---

<p>kvalitative)</p> <p>I verifikon shpjegimet duke parashtruar supozime , e mandej i vlerëson në raport me dëshmitë.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë</p> <p>Shpjegon rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.Qartë i ndan me të tjerët.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Tregojuni nxënësve se si gazrat sillen në temperatura të ndryshme. Përdorni një kungulleshë të vogël (me ajër) ku është ivendosur balloni i fryrë në majën e saj. Ngrohni kungulleshën dhe balloni do të zgjerohet. Nëse ftohet, ajo do të ç'fryhet. Kërkoni shpjegime nga nxënësit për këto reaksione. <p>Paraqitni idetë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha thërmijat lëvizin • Thërmijat e ajrit më mirë lëvizin kur janë të nxehura • Thërmijat e ajrit lëvizin më ngadalë kur janë të ftohta. <ul style="list-style-type: none"> • Mund të realizohet lojë në role që të paraqitet se si gazi lëviz ngadalshëm përreth, e mandej siç rritet temperatura më shpejtë. Kjo mund të realizohet në klasë dhe jashtë klasës. Atyre do t'u duhet më shumë hapësirë, ashtu siç gazi mundohet të zgjerohet. <ul style="list-style-type: none"> • Nëse janë në hapësirë të mbyllur, më shumë do të përplasen nëpër mure, më shpejtë dhe më fortë.. Kjo shkakton shtypje më të madhe. • Përderisa muret janë elastike, si tek balloni ato do të fillojnë të zgjerohen nga jashtë. • Bëni simulacion që tju ndihmoni nxënësve që ta vizuelizojnë lëvizjen e molekulave të lëngjeve dhe gazrave në një enë. • Nxirreni ballonin nga frigoriferi (sigurisht është mbledhur). Kërkoni nga nxënësit ta krahasojnë këtë rezultat me supozimet e tyre. • Nxënësit nëpërmjet të përdorimit të modelit të gazit, i shpjegojnë ndodhitë dhe parashikojnë çka do të ndodhë me ballonin nëse ngadalë fillon të nxehet. • ara mbarimit të orës, nxeheni kungulleshën dhe mbi të vendosni ballonin. Nxënësit le ta vendosin në frigorifer, dhe këtë le ta shqyrtojë orën e ardhshme. 	<p>Nxënësit ndoshta kanë bërë aktivitete të ngjashme nga lënda e Biologjisë në klasë të shtatë. Kjo mund ta rindërtojë me çka do të kuptet Ова може да се надогради termi i shtypjes tek gazrat. Qe një shembull të një loje të këtilla në role: https://youtu.be/I9xB4hhWvXY</p> <p>https://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/states-of-matter (shiko tabularin 'Ndryshimet në fazë'). (simulacioni është i mundshëm në gjuhën shqipe, maqedonase,serbe dhe turke)</p>	
--	---	---	--

	<ul style="list-style-type: none"> • Përfundoni thërmijat në gazin lëvizin përreth lirisht dhe shpejtë. Ato kur përplasen krijojnë shtypje. Në temperatura më të mëdha lëvizin më shpejtë dhe më shpesh përplasen . Me këtë zmadhohet shtypja. 		
